

BODEN GRUND



PËRSHKRIMI

Astar epoksid dy komponentësh me bazë uji i një cilësie të lartë. I përshtatshëm për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm para aplikimit të Boden Farbe dhe Ocean Blue

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Depërtim i lartë
- Ngjitje e shkëlqyer
- Përforcim i sipërfaqes
- Rezistencë e lartë kimike
- Rezistencë e lartë ndaj gërryerjes (konsumimit)

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Përdoret në të gjitha dyshemetë e brendshme dhe të jashtme, ku duam të krijojmë ambiente me rezistencë të lartë kimike dhe mekanike, pas vendosjes së shtresës së betonit dhe para aplikimit të bojës epokside si dhe për lyerjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të betonit ku kemi aktivitet të lartë mekanik si edhe agresion kimik para se të trajtohet me bojën epokside, të tilla si oficina, spitale, ambiente industriale, pompa karburanti, depo farmaceutike, etj, para se të bëhet trajtimi final me bojën epokside.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Rezinë epokside
Densiteti EN ISO 2811-1	Komp. A $1,15 \pm 0,02$ gr/ml Komp. B $1,05 \pm 0,02$ gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	100%
Raporti i përzierjes	3 : 1
Viskoziteti	75 ± 5 KU
Koha e tharjes mes dy shtresave	30 - 60 minuta
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 10
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m ³)	≤ 0.2

PËRGATITAJ E PRODUKTIT

Përzieri fillimisht secilin komponent në enën e tij të ambalazhimit. Më pas hidhni komponentin B brenda enës së komponentit A dhe përziejini mirë për rreth 5 minuta.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet duhet të jenë të thara plotësisht, të pastra dhe pa elemente që pengojnë ngjithshmërinë e astarit. Riparoni të gjitha plasaritjet dhe pjesët e dëmtuara duke përdorur produktet e linjës Deutschcolor.

APLIKIMI I PRODUKTIT

Aplikimi i produktit Boden Grund bëhet me anën e një furçe ose rruli. Fillimisht derdheni produktin në mënyrë të rregullt mbi sipërfaqen e paratrajtuar sipas efektit dekorativ që kemi paracaktuar. Më pas ndihmojeni produktin të nivelohet dhe të mbulojë të gjithë sipërfaqen me anën e një rruli. Pasi e gjithë sipërfaqja është mbuluar nga produkti, atëherë rikalojeni lehtësisht atë me anën e një rruli në mënyrë që sipërfaqja të dalë sa më uniforme. Pastroni furçat, rrulat dhe mjetet e tjera të punës me ujë para se boja të thahet.

PAKETIMI

4 KG

RUAJTJA

36 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

